




KOSOVA

Ballina: Besarta Ukehaxhaj



BESARTA UKEHAXHAJ,


shqiptarja që po bënë
histori suksesi në Gjermani
- e fuqishme në biznes,
mjeshtrë e bukurisë dhe kozmetikës



Koronarografi

Elektive

300€





**Besarta Ukehaxhaj,
shqiptarja që po bënë
histori suksesi në Gjermani
- e fuqishme në biznes,
mjeshtre e bukurisë dhe kozmetikës**

Në botën e emigracionit çdo histori suksesi ka brenda vetes sakrifica, lot, mund dhe ëndrra të mbajtura gjallë me shumë përkushtim. Një prej këtyre rrëfimeve të bukura është ajo e Besarta Bukolla- Uke-haxhaj, një femre që nga një fshat i vogël i Gjakovës arriti të ndërtojë një jetë të suksesshme dhe një biznes të njohur në Gjermani, të quajtur “Besarta Friseur •Schönheit •Kosmetik”. Krenare për familjen e saj Bukolla dhe e lumtur për rrjedhën e jetës, Besarta rrugëtoi me kokën lart në rrugën e jetës... Tash është mjeshtre e licencuar, pronare e sallonit të saj të bukurisë, krijuese e linjës së produkteve kozmetike “Besarta Professional” dhe së shpejti themeluese e një akademie profesionale për trajnimet në këtë fushë. Në këtë intervistë ekskluzive për revistën tonë “Kosovarja”, Besarta rrëfen për fëmijërinë, sfidat, ëndrrat dhe sukseset që e kanë formuar për atë që është sot...

Si e kujtoni fëmijërinë dhe ëndrrat e asaj kohe?

- Jam rritur në fshatin Babaj i Bokës, mes njerëzve me zemër të madhe dhe vlera të forta tradicionale. Si vajzë ëndërroja të bëhesha dikush që sjell ndryshim e bukuri në jetën e të tjerëve, edhe pse atëherë nuk e dija që pasioni për flokët dhe estetikën do më shoqëronte gjithë jetën.



Në moshën 17-vjeçare u shpërngulët në Gjermani. Si e përjetuat këtë ndryshim?

- Ishte një hap i madh, u martova dhe lashë gjithçka të njohur pas. Fillimet ishin të vështira: gjuha, kultura e re, malli për familjen dhe ndërtimi i një jete të re. Por, mbështetja e burrit dhe motrës sime më dha forcë. Fillova kursin e gjuhës dhe më pas rrugën profesionale.

Cila ishte sfida më e madhe atëherë?

- Të balancoja jetën si nënë e re dhe të punoja për ëndrrat e mia. Çdo ditë ishte sfida, por gjithmonë kam besuar te vetja dhe nuk jam ndalur. Çdo vështirësi më ka bërë më të fortë.

Si arritët të ndërtoni karrierën dhe biznesin tuaj?

- Pas kursit të gjuhës, ndoqa kurse profesionale në dizajn dhe frizeri. U pranova në Ausbildung në Schwäbisch Gmünd dhe më vonë vazhdoja me “Meisterschule” në Bayern.

Pas shumë mudi dhe studimi mora titullin “Meister” dhe në vitin 2023 hapa sallonin tim.

Sot punoj së bashku me familjen dhe e drejtoj këtë biznes me shumë pasion.

Sa ka ndikuar familja në këtë rrugëtim?

- Familja është themeli i çdo suksesi që kam arritur.

Burri im më ka qëndruar pranë në çdo hap.

Vajza ime, Fiona, është krahu im i djathtë dhe sot ndjek praktikën të unë.

Djali, motra dhe mbesa janë, gjithashtu, pjesë e stafit.

Është bekim të punosh me njerëzit që i do...

Si lindi dashuria për profesionin e bukurisë?

- Që e vogël në fshat rregulloja flokët e motrave dhe shoqeve. Ky pasion më ndoqi edhe në Gjermani.

E, me kalimin e viteve dhe përvojës u

kthye në profesion, mission dhe identitet.

Ç'domethënie ka për ju titulli "Meister" në Gjermani?

- Është kurorëzimi i shumë viteve mund dhe përpjekje. Në Gjermani ky titull ka peshë të veçantë, të jep të drejtën të hapësh biznes dhe t'i trajnosh të tjerët. Për mua është krenari dhe përgjegjësi për të qenë shembull për të tjerët.

Sipas jush, çfarë e dallon një profesionist të mirë në fushën e bukurisë?

- Jo vetëm teknika, por edhe zemra, ndjeshmëria dhe përkushtimi. Profesionin ynë ka të bëjë me vetëbesimin e njerëzve. Një profesionist i mirë dëgjon klientin, respekton punën dhe është gjithmonë i hapur të mësojë.

Si të lindi ideja për të hapur sallonin tuaj?

- Pas përfundimit të shkollimit dhe përvojës, ishte koha të krijoja diçka timen. Në vitin 2023 hapa sallonin tim me emrin "Besarta", emër që përfaqëson mundin, krenarinë dhe identitetin tim shqiptar në diasporë.

Si është të punosh me familje?

- Është ndjenjë e jashtëzakonshme. Burri, vajza, djali, motra dhe mbesa janë pjesë e sallonit. Jemi ekip i bashkuar me dashuri dhe përkushtim. Kemi krijuar një ambient pune që është si një shtëpi e dytë.

A ka pasur momente kur keni menduar të dorëzoheni?

- Po, ka pasur ditë të lodhshme dhe emocionale. Por, fëmijët e mi më kanë

dhënë forcë dhe besim në Zotin më ka mbajtur në këmbë.

Sot jam falënderuese e të gjitha sfidave, sepse më kanë bërë më të fortë.

Na tregoni për produktet tuaja kozmetike. Si lindi kjo ide?

- Nga përvoja në salon pashe nevojat e klienteve dhe vendosa të krijoj një linjë produktesh me emrin tim. Çdo produkt është përzgjedhur me kujdes, i testuar dhe i krijuar për cilësi të lartë, duke respektuar standardet më të larta.

Çfarë e veçon këtë linjë nga të tjerat?

- Janë produkte me përgjegjësi personale, të testuara në praktikë, jo prodhime masive. Çdo formulë dhe detaj është menduar me dashuri dhe përkushtim profesional.

Së shpejti do nisni edhe me trajnime. Na tregoni më shumë për këtë risi?

- Po, shumë shpejt do të hap akademinë time profesionale për frizeri, make-up, lash-lifting dhe menaxhim salloni. Qëllimi im është jo vetëm të mësoj teknika, por të frymëzoj dhe motivoj vajza dhe gra që të besojnë te vetja dhe të ndërtojnë të ardhmen e tyre me dinjitet.

*

Për fund të shtojmë se historia e Besarta Ukehaxhajt është një shembull i fortë se ëndrrat nuk njohin kufij dhe se me pasion, përkushtim dhe dashuri për atë që bën, mund të ndërtohet një jetë e re dhe një emër i respektuar kudo që të ndodhesh. Një histori që frymëzon çdo grua të mos heqë dorë nga ëndrrat e saj...

Nderim Neziri



Politikanët tanë mendojnë se janë të pazëvendësueshëm!

A mbajnë shtet politikanët dallaveraxhinj? Kjo është një pyetje që duhet shtruar sot çdo shqiptar, i cili do të mendonte si ta ndryshojë shtetin. Prandaj, kemi nevojë për ndryshime urgjente që ta mbrojmë shtetin, për të cilin sakrifikuan mijëra e mijëra shqiptarë, pra Republikën e Kosovës...

Para lufte ish-pjesëtarët e MUP-it të Serbisë e kishin ftuar në bisedë informative një punonjës teknik të ndërmarrjes "Rilindja". E kishin pyetur se ku i ka të bijtë që kishin ikur nga shtëpia për të mos shkuar në ushtrinë serbe. Me kaq ishte mbyllur biseda informative për njeriun e stafit të kësaj ndërmarrjeje.

Dhe, me t'u kthyer në zyrë, kishte angazhuar një gazetar, shok të vetin, që t'ia bënte një lajm sa më sensational për maltretimin e tij nga policia serbe, që i kërkonte djemtë për ushtri.

Dhe, gazetari kishte shkruar atë që kishte kërkuar ai... Të nesërmen, po ashtu, e thërrasin në polici, sepse e kishin parë lajmin e tij në gazetën e

ditës, e që nuk përkonte me realitetin. Inspektori nga Novi Sadi e kishte pyetur:

"Edhe dje ke qenë këtu, te unë, apo jo?"

"Po", i përgjigjet ai.

"A t'kam rrahur, a t'kam maltretuar?"

"Jo", ishte përgjigja e tij.

Dhe, pas atyre pyetjeve inspektori nxjerr nga sirtari gazetën e ditës, "Shkëndijën". Në të ishte mu lajmi i shkruar për të...

"Po kjo që shkruan këtu, ç'është?!", i thotë ai.

"Gazetari ka shkruar. Unë nuk di...", ia kthen ai.

"Po, a?!", i thotë i qetë.

Dhe, pa një e pa dy i hynë pendrek derisa ia mavijosë trupin...

"Tash shkruaj se, vërtet, të kam rrahur e maltretuar!", i thotë ai teksa e urdhëron të del nga zyra e tij...

Kthehet i maltretuari në zyrë dhe kur e shohin shokët e punës në ç'gjendje ishte, secili ndien keqardhje.

"A të shkruaj se, vërtet, të paska rrahur keq?!", e pyet gazetari.

"Jo, burrë, hiq asaj pune se ia kam pa sherrin atij lajmi!", thotë ai, teksa e këshillojnë që të shkojë në shtëpi e të mos e shohin të tjerët në atë gjendje... Kështu, pra, rrena nuk të çon në vend të mirë...

E, me rrena e mashtrim po jetojnë edhe shumë politikanë tanë të cilat në kokat e tyre kanë krijuar bindjen se gjithmonë do të jenë në pushtet!

Burim Bajrami



PSE E URREJMË TË SOTMEN?

Gjatë krizës të kësaj kohe të pakohë, të kësaj kohe e jete çfarë po e përjetojmë, hasi në persona të ndryshëm që nuk i kisha parë kurrë më parë të pasur dhe, ja, erdhi koha e tyre...

SOT KA NDRYSHUAR SHUMËÇKA!

S'e kam prej nostalgjisë, siç do më thoshin...

Por, në kohën paraprake, jo të largët, miqtë kanë qenë të vërtetë, pa maska.

Po ashtu, solidariteti ndaj njëri-tjetrit, për njëri-tjetrin ka qenë për lakmi dhe që na ka mbajtur në kohë të rëndë, të zorshme...

Jo vetëm miqtë, sot ka ndryshuar e ndërruar shumëçka!

*

Të gjithë e kemi jetën tonë.

Jetojmë, por në këtë jetë gjithmonë mungon dhe na mungon diçka.

Për këtë jemi edhe në këtë jetë, që të arrijmë aty ku na plotësohet mungesa.

Kur Dante Aligieri shkruante "Komedinë hyjnore", ka thënë: "Atë ditë kur njeriu do të lejojë të shfaqet dashuria e vërtetë, gjërat që duken të organizuara do bëhen rrëmujë dhe do të jenë kundërpeshë e gjithë asaj që ne e mendojmë si të drejtë, që është e vërteta".

Bota do të bëhet e vërtetë vetëm kur njeriu do të dijë të dashurojë. Deri atëherë do të jetojmë duke besuar se e njohim dashurinë, por pa e pyetur kurrë guximin që ta përballojmë ashtu siç është në realitet.

*

Mirë e kanë pasur ata që kanë thënë: Dashuria është një forcë e egër.

Kur do të përpiqemi ta kontrollojmë - na shkatërron.

Kur tentojmë ta burgosim - na bën skllevër.

Kur mundohemi ta kuptojmë - na lë të hutuar...

*

Përse i duam disa njerëz e ca të tjerë i urrejmë? Pse lindim, nëse një ditë duhet të vdesim?

Koha m'i imponon t'i bëj këto pyetje sikur atëherë kur nënës sime ia bëja kur isha i vogël, fëmijë...

"Kuku, djali jem, po ku, kah, çka po t'bie në mend?!".

E sotmja ta qon mendjen kahmos...

Gani Dili

KOSOVARJA

magazinë e pavarur
për familje

www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:

Gani DILI

Redaktor përgjegjës:

Isa ILAZI

Menaxher:

Driton DILI

Redaksia:

Safet Krivaça (reporter i lirë)

Nderim Neziri (redaktor)

Besiana Dili

Drenushë Haredinaj

Ardita Dili

Edona Vllasaliu - Bajoku

Xheneta Spahiu

Denisa Oruqi

Dizajni:

Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:

Fahu postal 18, 10000 Prishtinë

Tel: 038 51 75 75

Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:

Tel: +383 44 143 448;

Email: marketing@kosovarja-ks.com



Jam në hall nga burrat e martuar!

Jam motër medicinale. Punoj në një ordinancë private në Tetovë. Punë ka mjaft, por edhe fjalë shumë. Secili që vjen në ordinancë tregon për qejf të vetit se është kavalier, se e duan femrat, aq sa koka mu ka bërë lëmsh...

NJERËZIT GËZOHEN KUR JANË TË SHËNDETSHËM, TË MIRË, TË BUKUR...

E, mua po më pengon bukuria, sepse secili që vjen në ordinancën ku punoj, posa më sheh, nis t'më vardiset aq sa ia kam marrë inati vetit sa dua ta lë punën dhe të merrem me ndonjë zanat sa për të mbijetuar.

JAM E BUKUR, AMA NË HALL NGA BURRAT E MARTUAR!

Ka pesë vjet që punoj në një ordinancë private në Tetovë dhe punët na shkojnë

mirë, meqë mjeku te i cili punoj është profesionist i dalluar, andaj terminet gjithmonë janë të rezervuar për secilën ditë. Por, halli im, e që tregova edhe më lart, është me pacientët, sidomos burrat e martuar!

Disa herë i kam treguar mjekut për këtë gjë, por ai nuk e bën edhe aq problem. Më thotë: "Mos i dëgjo ç'të thonë!"

Si duket, mjeku më ruan për vete me vetë faktin se gjithmonë më shikon me një qeshje të lehtë, e që ma tërheq vëmendjen...

E, se është kështu, këtë bindje ma përforcon rasti i para do ditësh, kur mjeku më tha: "S'kanë faj që pacientët të vardisen, meqë të ka falur Zoti të bukur dhe gjithse-

cili që vjen në ordinancë mbetet i befasuar me bukurinë tënde!"

E, ç'faj kam unë që jam e bukur?!

Shyqyr që ma ka dhënë Zoti bukurinë që e kam!

I jam mirënjohës Zotit për bukurinë dhe aftësinë time si motër medicinale, sepse s'ka punë që më thotë mjeku e të mos arrij ta kryej!

Thënë shkurt, s'më mbetet tjetër pos ta uli kokën e ta kryej punën time, e të tjerët le të flasin dhe le t'më shikojnë sa të duan!

Le ta heqin mallin për gratë e tyre duke më shikuar mua...

E kam mirë a keq?

Xhamadije I., Tetovë



Pse?

Dashuroni: Pse?
Nuk u ecë mirë shkollimi: Pse?
Nuk jeni martuar ende: Pse?
Jeni ndarë nga e dashura a i dashuri: Pse?
Jeni ndarë nga gruaja a burri: Pse?
Nuk jeni i punësuar a e punësuar: Pse?
Keni probleme: Pse?
Nuk bëni gjumë të mirë: Pse?
Nuk keni disponim: Pse?
Jeni në depresion: Pse?
Nuk keni para: Pse?
... Pse?

Gjeneratat e sotme s'kanë ideale!



Ulur në betonin e trotuarit pranë banesës, një djalë i ri për të cilin do shkruaja gjerësisht më vonë, përlotej duke mallkuar nënën dhe babanë! Në fakt, ai nuk e kishte asnjërin pranë vetes, edhe pse të dytë jetonin: Nëna jetonte me vjet në Perëndim, e babai në Prishtinë!

Një baba me shumë probleme, madje edhe pasi kishte dy fëmijë, ishte ndarë nga gruaja. Fëmija i vogël jetonte me nënën, ndërsa i madhi "kinse" ishte me babën. Prindërit kishin menduar t'i hakmerreshin njëri-tjetrit duke qeruar hesapet përmes djalit dhe nëna që ishte gjetur para aktit të fundit, kishte ikur jashtë, duke e lënë fëmijën e madh rrugëve.

Dhe, sa herë kaloja pranë shtëpisë ku jetonte, ai qëndronte ulur mbi një beton. Kur binte shi futej nën "ombrellën" e ballkonit dhe aty qëndronte teksa i kthehej babai që një Zot e di se ku shkonte e me kënd rrinte...

PSE E MORA SHEMBULL DJALIN?

Një ditë, teksa kaloja pranë tij, i thashë tim biri, Drinit, ta merrte shembull atë djalë. Djalit tim i erdhi keq. Ai e njihte nga shkolla: pa nënë, pa "babë", pa askënd... Për një moment më iku mendja...

Krahasimi me kujdesin tim ndaj fëmijës është sa largësia e tokës me qiellin! Madje, e pata dërguar tim bir t'ia bëja edhe analizën se a ka në gjak elemente narkotike, sepse Prishtina është mbushur me gjithçka dhe prindërit e kujdesshëm po ua bëjnë fëmijëve të tyre analizën. Laboranti më tha se personi mund të jetë edhe anonim, me shifër apo me nofkë. "E, vajzat a e bëjnë këtë test?", i thashë laborantit. "Me të madhe!", ma ktheu laboranti. Në çast, mu kujtuan disa vajza të reja afër zyrës sime, të cilat ulur në shkallët e fashodit, zgjasin këmbët në asfalt dhe nuk i tërheqin pa i rënë burisë furishëm! Dhe, teksa bisedoj me laborantin, më shkoi mendja edhe te më e keqja. Kisha lexuar se si një nënë ishte detyruar ta thërriste policinë disa herë në ditë për ta qarë të birin në burg, meqë e rrihte sa herë që nuk kishte para t'i jepte. Ajo i kishte thënë lamtumirë gëzimit qëkur djali i saj nisi të merrte drogë...

Dhe, kur u krye storja që më erdhi në mendje, laboranti ende fliste para meje. Fliste, por unë isha shkaputur nga rrëfimi i tij...

Vetëm sytë më kishin mbetur te buzët e tij që përplaseshin mbi njëra-tjetrën...

MJERË NE QË JEMI PRINDËR!

Dhe, për të thënë diçka, fola:

"Mjerë ne që jemi prindër!"

"Jo!", ma ktheu dhe vazhdoi: "Por, secili prind duhet ta përcjellë fëmijën e vet se ku shkon, ku rri, me kënd rri..."

"Po, o mik, por prindërit e sodit nuk janë si ata dikur! Janë më të tërhequr nga idealet e jetës.

Konkretisht, fqinji im, që e lë djalin rrugëve, është një baba që nuk i përket kohës së idealeve: Nuk ndjen as dhimbje, as gëzim e as hidhërim! Nuk di as vetë pse jeton!

Keq, a?!"



MARITIM

MARINA BAY RESORT & CASINO

Make the most of your holiday with our special offer on Sea View Rooms during the high season

SEA VIEW

Special Offer

STAY 6 NIGHTS
PAY ONLY 5!

Offer valid until July 10th
A limited number of rooms available.
Book now!

FOR INFO & RESERVATION
+355 69 6041000 | info@marinabay.al



Nga një kënd ndryshe...

A ka mbetur të jetohet në Kosovë?

Nuk ka punë në Kosovë. Papunësinë e ka shkaktuar qeveria nga të korruptuarit! Të korruptuarit ia kanë humbur vlerën popullit tonë...

Takova mikun tim që ka nisur një biznes, por që në start i ka hasur sharra në gozhdë, sepse, siç thotë ai, tatimi i lartë, rryma e shtrenjtë, qiraja e shtrenjtë pa hesap, e shumë të tjera...

Furnizuesit e tij e gënjen sy më sy: Ta kam nisur mallin, e malli nuk është askund! Ia nis nga Kurani e deri te fëmija, duke bërë be e erfe! E, për të qenë edhe me keq, në Kosovë tërë jeta është e lidhur me administratën publike: shkon në sportel ta kryesh një punë, zyrtari t'i merr letrat, kurse nuk e ndal

telefonin...

Pas pak kthehet kah ti dhe të thotë pse ke ardhur...

Ose, shkon te mjeku dhe derisa të kontrollon flet me tjetrin e nuk e ka mendjen fare te ti...

Tjetër, shkon te stomatologu dhe, pasi të ulë në "karrigen e frikës", nis e flet me ndokënd në telefon.

E, edhe nëse e ke gojën plot shkumësa, duhet ta mbash gojën hapur derisa ai e kryen punën me tjetrin...

E, kur fillon të punojë në dhëmbin tënd, ia kris muhabetit: shan politi-

kanët...

Isha para pak ditësh në një ordinancë stomatologjike dhe mbeta gojëhapur, duke e dëgjuar mjekun teksa fliste keq për të tjerët, kurse e lavdëronte veten!

Ma kish mbushur gojën shkumësa dhe as që e kishte gajle se në ç'hall isha...

Dikur plasa dhe i thashë: "Largomi shkumësat se më janë kapur për qiellzë të gojës!"

Pasi m'i nxori, i thashë: "Nuk mund të flisja me shkumësa në gojë, por shihe veten! Prej kur jam këtu e ke

ndal punën një katër herë, duke folur sa me njërin e sa me tjetrin... E, po t'ishë ti në rregull do e mbaje rendin në ordinancën tënde e nuk do veproje në këtë mënyrë!" "Kam shumë termine e nuk po mund t'u dal në krye!", ma ktheu.

SI I RA NASTRADINIT SHKOPI NË KOKË?

Dhe, ra rasti i stomatologut e ma kujtoi Nastradinin. Nastradini kishte pasur shumë punë. Nuk i mbante në mend gjërat dhe, meqë i ishte zhvilluar harresa, gruas i tha: "Më ndihmo, grua, ta kaloj harresën! Të premten e kam një punë. E, që të mos e harroj terminin, merre shkopin dhe ma lë mbi tavolinë, në mënyrë që ta di se është e premtë".

Gruaja një ditë lë shkopin mbi tavolinë dhe, me të hyrë Nastradini brenda, shkopi i përplasat në kokë. Shpejt e shpejt i thotë gruas: "Sot nuk është e premtë, grua, ç'dreqin e ke lënë këtu shkopin?!". "Është nata e së premtes dhe u desh me e mbajt marrëveshjen", ia ktheu ajo. "Më dëgjo grua, nga sot, në këtë shtëpi, o shkopi o unë!", tha ai.

SECILI MJEK TË MBAN "LIGJËRATË"!

Shkoj te tjetri mjek për kontroll, e ai më thotë:

"Me heq peshë se do të kesh më vonë probleme kardiake!". "O doktor, falënderohuni për peshën që kanë njerëzit se po të ishin të gjithë pa mbipeshë nuk do u vinte kush dhe ju më nuk do ishit mjekë, por kushedi çka tjetër! Unë, po të mos kisha mbipeshë, ç'do të kërkoja këtu?!", i thashë. Të pranishmit qeshën...

Në fund, mjeku më rekomandoi dietë. Më dha një recetë të madhe me barëra dhe ec e mos i merr... Por, doktorët tanë nuk janë si Nastradini që të fitojnë një dhjetëshe më pak. E, për këtë po e tregoj punën e dhjetëshes:

Një grup të verbërish kishin arritur deri te lumi dhe prisnin që dikush t'i nxirrte andej lumit. Nastradini u tha se do i bartte andej secilin nga dhjetë grosh.

Nxori disa dhe u kthye t'i merrte të tjerët.

Por, kah mesi i lumit një të trashë, e që kishte shumë peshë, e hedhë në lum.

Kur e hodhi i verbëri nisi të bërtiste e britmën e kuptuan të verbrit tjerë dhe i thanë:

"Nastradin, e hodhe dikë në ujë e ai do mbytet!".

"Në fund të fundit, një dhjetëshe më pak a më shumë s'ka rëndësi!", ua ktheu Nastradini.

PSE NUK PO NA BËN ZOTI SHTET?

Kur ta jep Zoti ta jep, ama neve nuk po na bën Zoti shtet, Shihni si po sillet puna në Kuvendin e Kosovës, edhe pse kanë kaluar 4 muaj nga zgjedhjet!

Kështu, pra, si po shkojnë punët, më duket se Zoti nuk e ka shkruar të na bëjë shtet. Me zor nuk mund të bëhet shteti!

Dhe, edhe këtë po e lidhi me një

rast që i kishte ndodhur Nastradinit: I kishte vdekur gruaja Nastradinit dhe pas një kohe merr gomarin dhe niset për diku...

Me të arritur te shtëpia e një vejushe, i bërtet gomarit: "Ush gomar në botën tjetër!".

Vejusha e dëgjo dhe i tha:

"Pse të vete gomari në botën tjetër, efendi?!".

"Më ka vdekur gruaja, zonjë, e dua të shkoj ta shoh".

"Prit sa t'ia bëj një tortë e dërgoja!".

Nastradini priti derisa u bë torta, e mori me vete dhe u nis. Kur u largua paksa, u ndal dhe e hëngri tortën... E, teksa kthehej në shtëpi, e takoi përsëri vejushën.

Ajo i tha:

"Nastradin, pse dukesh i mërzhitur? Qenke mërzhitur për gruan, a?!".

"Jo zonjë, nuk është që jam mërzhitur, por mua e ty na kish gjetur një e keqe e madhe: burri yt atje ishte martuar me gruan time!".

"Efendi, a edhe këtë të zezë e paska bërë burri im, a?!".

A martohemi edhe unë e ti për inati të tyre?!".

S. Murturi



Si më nderoi plaku në odën e burrave?

Sillen mendimet e mia përgjatë dhomës. M'u kujtua një ngjarje në një odë të fshatit Mirash të Ferizajt. I kishte vdekur babai një moshatarit tim, që më quante dajë, por kurrë s'e kam ditur pse e kam dajë. Babai kishte vdekur moti, e unë kisha qenë tepër i vogël të pyesja pse e kishim dajë filanin që vinte në odën tonë.

Shkova ta vizitoja dajën dhe kur arrita atje u drejtova drejt e në odë. Një sallon 13 metra i gjatë, që shfrytëzohej për odë

burrash.

Më ulën në fund të sallonit, atje ku ndodhej përballë një plak. Ishte mbi 90 vjeç. Pasi mbretëroi heshtja, u hapë biseda ngushëlluese.

Plaku, që e kishte pranë një kujdestar interpretimi, ofroi veshin afër tij dhe kujdestari i tregoi se kush isha.

Plaku i dha të ngrihej në këmbë, por të tjerët reagueshan, duke i dhënë se s'ka nevojë të ngrihej.

Pas pak plaku tha: "Unë dua të shkoj te ai e jo ai të vjen këtu!".

U ngrit dhe e morën dy vetë për krahësh dhe e ofruan pranë meje.

Kur më mori ngrykë filloi t'i dilnin lot nga sytë...

Në ato çaste u ndjeva ngushtë për gjendjen e tij.

Oda ishte plot burra dhe diçka e madhe duhej të kishte ndodhur që ai u ngritë e erdhi te unë, thashë me vete.

Nuk ishte ngritur për asnjë komandant policie, që kishin shkuar në pamje, meqë djali i të vdekurit ishte komandant policie në Prishtinë.

Njëri tha: "Ti, bre burrë, duhet të jesh i madh se plaku nuk është ngritur në këmbë deri më tani për askënd!".

"A i ke përngjarë babës?", më tha plaku.

"Jo, nuk i kam përngjarë shumë, por ka diçka që kemi të përbashkët", i thashë.

Pas këtij dialogu më tha se kishte qenë mik e shok i besës së babait tim, qyshkur kishin qenë ballistë në male dhe e kishin shkelur në këmbë Shqipërinë deri në Tivar. Unë, për ta relaksuar situatën e krijuar, që te të tjerët zgjoi interesim të madh ardhja ime në odë, i thashë:

"Unë mendova se vetëm pse jam i madh me trup të bëra përshtypje e u ngrite në këmbë për mua! Por, po e tregoj një mesele: E pata gjetur një këlysh të vogël dhe e qova në shtëpi. Baba u qua nga vendi që ta shihte këlyshin dhe unë po e gënjeja se ishte i racës së Sharrit, bëhet kështu e ashtu, e mbytytë ujkun e lavde të tjera për këlyshin, vetëm e vetëm që të mos ma humbte".

Ai ndërhyri: "Ky nuk bëhet qen i madh, biri im, sepse është pinok. Nuk na duhet qeni i vogël në oborr, sepse qenit të vogël askush nuk ia ka frikën e të madhit po".

E, unë mendova pse jam i madh me trup u ngrite në këmbë për mua!".

"Jo, hatri i babait tënd erdha te ti!", ma ktheu plaku.

S. Krivaça

COURTYARD[®]

BY MARRIOTT

Prishtina



info@courtyardprishtina.com

038 790 000

E tradhtova burrin, ia dhashë një grusht vetes!



E tëra ka nisur me një telefonatë të gabuar dhe prej atij momenti gjithçka ka nisur spontanisht. Një herë më ka thirr ai dhe më është betuar se ka kërkuar një të afërm familjar në numrin tim, mirëpo e vërteta ishte se ai e kishte ngatërruar vetëm shifrën e fundit të numrit.

I kam thënë "alo" dhe e kam dëgjuar një zë të ëmbël mashkulli, i cili më ka kërkuar falje, por unë nuk e kam lejuar që t'ma ndërpres lidhjen menjëherë.

Pas atyre fjalëve e kam thirr pas pesë minutash po në atë numër dhe e kam pyetur si e kishte emrin, sa vjeç ishte dhe nga ishte. Më tregoi pak nga jeta e tij, edhe pse disa herë në fillim ma ndërpreu lidhjen dhe kërkoi ta lija të qetë.

Mirëpo, unë vazhdimisht ia cingëroja telefonin, i dërgoja mesazhe deri në momentin kur kisha marrë përgjigjen që e kërkoja prej tij. Thënë të drejtën, edhe frikësohesha të nisësha nga Suhareka në Prishtinë për të, sepse dyshoja se ai mund t'më mashtronte dhe të mos më dilte fare në takim...

ME SINQERITET MË PËRVETËSOI

U nisa për në Prishtinë dhe le të dilte ku të dilte.

E kishim lënë të takoheshim te "Skënderbeu". Ai paraprakisht ma kishte përshkruar veten

se çfarë do të vishte atë ditë...

Unë, me qëllim, në vend se t'i thosha se do të vishesha ashtu siç isha me të vërtetë, i kisha thënë se isha krejt në të zeza, sepse nuk mund ta imagjinoja veten në një pozicion të poshtërimit, nëse ai nuk do më dilte në takim. Mirëpo, kur shkova në vendin e caktuar, nga larg pash një mashkull ashtu siç e kishte përshkruar veten, i cili pristte duke shikuar orën në dorë.

I shkova nga prapa dhe duke e ditur se ai ishte vetë, iu prezantova.

Të parën fjalë që ia thashë ishte: "A po të pëlqej?"

Dhe, pasi më shikoi nga këmbët te flokët, ma kthehu:

"Nuk ka rëndësi për mua bukuria e jashtme!"

Pastaj, ecëm disa hapa duke folur diçka të parëndësishme...

Ai më vonë më tha se do të shkonim në një lokal të qetë për të pirë kafe dhe për të biseduar dhe unë pranova menjëherë.

SI T'I TREGOJA SE ISHA E MARTUAR?

E dija se askush nuk më njihte në Prishtinë dhe kjo ishte lehtësi e madhe për mua.

Paramendo sikur të ishim në Suharekë, as që do guxoja të bëja një hap në shoqëri me mashkull tjetër veç burrit.

Isha në hall të madh se a duhej t'i tregoja apo jo të vërtetën time. E dija se ai menjëherë do të mund të ngrihej e do shkonte.

Sidoqoftë, vendosa rrugën e drejtë ta ndjekja dhe më ndihmoi Zoti.

Dhe, derisa zihesha në vete se çfarë duhej të bëja me atë që e kisha përballë, kamerieri ma shkundi memorien. I thashë një lëngë pjeshke dhe u ktheva kah ai ta dëgjoja me vëmendje derisa më tregonte për veten... Megjithatë, e dija se duhej t'i flisja edhe unë për veten. Vendosa aty për aty që të mos i tregoja menjëherë se isha e martuar, sepse

doja ta lija për më vonë.

I thashë se e vetmja arsye që më kishte shtyrë të vija në Prishtinë ishte fakti i thjeshtë se kisha dëshiruar të zbuloja se kush fshihej pas atij zëri të bukur në telefon.

Në fund të fundit, e dija se nuk më shkruante askund në ballë se isha e martuar...

E, kjo ishte gjëja më e rëndësishme, sepse përpiqesha që të shfaqesha përpara tij sa më e sinqertë dhe, në fakt, deri atëherë nuk e kisha gënjer asgjë, por me siguri do ta gënjeja më vonë.

Nuk mund të përshkruaj sesi dukej ai në ato çaste: i ndezur pak në fytyrë, me buzë të kuqe dhe me një buzëqeshje që kurrë nuk i largohej nga fytyra.

Më pas më propozoi të ecnim.

Dhe, kur erdhëm në një bllok ndërtesash në Lagjen "Ulpiana", më tha të ngjiteshim në banesën e tij, në katin e katërt të një ndërtese.

E MARTUAR SA PËR SY E FAQE...

"Këtu jetoj unë", më tha kur e hapi derën dhe më shtyu të hyja brenda. Pastaj, i mbushi gotat me një lëng pemësh dhe erdhi dhe u ul pranë meje në një dhomë pritjeje.

Ndihesha keq dhe, thënë të drejtën, nga pak edhe frikësohesha prej tij: kisha hyrë në banesën e një mashkulli të cilin ende nuk e njihja mirë...

Pas disa minutash ma mori gotën nga dora dhe u ngritë në këmbë. Më tha: "Dua të tregoj diçka, por mos u shqetëso: unë jam i martuar!"

Në çast qesha.

"Po qeshi, sepse edhe unë jam e martuar!", i thashë shkurt, duke mos ia fshehur të vërtetën time.

Dhe, kur prita se kjo do të ndikonte negativisht te ai, m'u ul në prehër dhe më tha: "Sot po i tradhtojmë unë gruan e ti burrin!"


Fahrija, Suharekë



Arta Cakiqi

Trajnere Personale
Founder & CEO





Zot, më jep mend!

Bëra-ç'bëra dhe më së keqi më shkon puna me grua.

Ajo që i ha të gjitha, në fund të fundit, është gruaja.

Rashë natën të flija. U rrotullova sa në një krah në tjetrin, por gjumi nuk më zinte. Gruaja më tha:

"Çka nuk po rehatohesh?"

"Jam duke i menduar disa tema që t'i shkruaj!", ia ktheva.

"A për këtë nuk po fle, a?", ma ktheu ajo. "Po".

Ajo e ndezi dritën dhe më tha: Shkruaj!

Në çast m'u kujtua vaji i një lypësi, në sheshin qendror të Prishtinës. Dhe, fillova t'i shënoja ca vargje.

Ndërkohë, gruaja u shtri të flinte, por kur unë e lash fletoren ajo u zgjua dhe tha: "Lexo çka shkrove!".

Unë nisa të recitoja, si njeri që isha mbushur vrer nga misionet dhe debatet, e edhe nga pamjet në shesh.

Kur mbarova recitimin, gruaja më tha: "Vazhdo me këto vargje:

O Zot, jepi mend këtij budallai

Që kur lypësit flenë

Ky të mos rri zgjuar!".

"Grua, ke ide për poezi!" i thashë.

E, ajo ma ktheu:

"Të flesh me ty e të mos kesh ide, kjo nuk është e mundur! Më në fund, a e testove shpirtin?"

"Po. Uh, sa jam lehtësuar, grua! Nuk e merr me mend dot sa i lehtë jam bërë. Po fluturoj nga gëzimi që edhe ti po mësohesh të shkruash, e, kështu, më motivon më shumë", ia ktheva përgjigjen.

VARGJET E GRUAS...

U zgjova në mëngjes dhe i lexova vargjet e gruas.

Vargje me logjikë.

Ndër të tjerash, kuptova se personazhi me emrin "budallai" në poezinë e gruas isha unë.

Dhe, për të mos e paraqitur veten si personazh, i thashë gruas se do ia tregoj një

ngjarje për Nastradinin:

Kishte dëgjuar Nastradini se ish sëmurë prefekti i Ak-Shehirit.

I merr disa mollë në bahçe për t'ia dhënë.

Pasi troket në derë, prefekti ia hapë derën.

"Si je?", e pyet Nastradini.

"Keq, o Nastradin! Dy probleme i kisha.

Dhëmbët më dhembnin dhe i hoqa, por

tash veshët më dhembnin! Nuk di ku të gjej një mjek që më bën zgjidhje?", i thotë prefekti hoxhës.

Hoxha i tha:

"Ashtu sikur i hoqe dhëmbët, gjeje dikën të t'i shkulë veshët, sepse shumë ke dëgjuar me ta e nuk e ke bërë asnjë të mirë!".

"Demek, edhe mua ashtu, a?!", më tha gruaja.

"Jo, grua, tamam puna të t'i shkul veshët! Por, edhe këto po tingëllojnë si vargje", ia ktheva, sepse kishim kohë mjaft, meqë gjumi nuk na zinte.

S. M.

Thuaj mjaft dhimbjes dhe jorehatisë...

Shëro **venat e zgjeruara**



Brenda
40 min.

**me laserin
endovenoz**

Nostalgji, dashuri e vuajtje në vargje

Ditë më parë doli nga shtypi përmbledhja me poezi e Safet Krivaçës “Natë për vetëvrasje”, poezi të shkruara nga autori në kohë të ndryshme...

Autori, Safet Krivaça, gazetar dhe publicist, pas dy librave me përmbajtje shumë voluminoze “Ferri drejt varrezës masive” dhe “Ura e lotëve”, para lexuesve paraqitet me përmbledhjen e poezive “Natë për vetëvrasje”, poezi këto të shkruara në kohë të ndryshme, madje edhe në kohën kur ishte nxënës i shkollës së mesme, por edhe me poezi të ditëve të sotme. Por, e veçanta e autorit është se këtë herë librin me poezi e promovoi në Redaksinë e Revistës “Kosovarja”, redaksi në të cilën punon që nga paslufta e deri në ditët e sotme, në prani të stafit të Revistës, por edhe të bashkëpunëtorëve të shumtë. Me këtë rast, redaktori i librit, Gani Dili, editor dhe kryeredaktor i “Kosovares” tha: “Duke i lexuar vargjet e këtij libri, të ndarë

në cikle, krijohet përshtypja se ky libër është shkruar për një shtresë të lexuesve seriozë, apo për të gjitha ata që janë lexues të kujdesshëm a njohës të poezisë me figuracion të dendur dhe me kuptueshmëri, e që me këto poezi autori tregon qartë punën dhe vendosmërinë e tij, të një krijuesi që hapëron të arrijë atë që synon, e me këtë edhe ia ka arritur qëllimit. Motivet që fshihen nëpër poezitë përkatëse janë të ndryshme, sepse brenda “brumit” poetik (sidomos në ciklin e parë “Oda”) ngjeshën ide të thelluara të poetit, si në aspektin semantik ashtu edhe në atë tematik, në të cilat pasqyrohet një protestë e brendshme e poetit karshi padrejtësive që iu bënë më herët popullit shqiptar, por edhe tani nëpër krahina të tjera, të ndara padrejtësisht nga trangu shqiptar, si Toplica, Sanxhaku, Çamëria, Mali i Zi, Maqedonia, Lugina e Preshevës... Sidoqoftë, në disa vargje të autorit hasim edhe në pesimizëm, si pjesë normale e ndjenjave dhe e momenteve të caktuara. E këtë e hasim në disa poezi, e veçmas në “Natë për vetëvrasje”.

“I çela sytë
Floku yt s’më prekte në fytyrë
Ishte natë për vetëvrasje”.

Megjithatë, poezitë e Safet Krivaçës shprehin botën e njeriut tonë: ajo nuk zgjon kënaqësi, as nuk është argëtuese, as nuk të pushton me jashtësinë e saj. Ajo është gjurmim dhe shqiptim i thellësive të botës sonë, i krenarisë, i pësimeve dhe i tragjikes që e përcollën dhe e përcjellin njeriun tonë.

Për fund, Safet Krivaça, nëpërmjet vargjeve, sikur fton lexuesin që të lexohet poezia, të rritet numri i dashamirëve të fjalës së shkruar, sidomos i poezisë”. Ndërkaq, në fjalën e vet, autori i librit, Safet Krivaça, para të pranishmëve shpalo-si punën e tij shumëvjeçare në shkrimin dhe seleksionimin e poezive të tij, të cilat, siç tha ai, janë nostalgjia dhe shpirti i tij i vuajtur nëpër kohë, si dhe dashuria e madhe që ka për poezinë që nga koha kur ishte nxënës i shkollës së mesme e edhe në ditët e sotme.

Me këtë rast, autori falënderoi të pranishmit e këtij promovimi dhe u zotua se edhe në të ardhmen penda e tij poetike nuk do të ndalet.

E, për fund, s’na mbetet tjetër pos t’i urojmë autorit që të sjellë edhe krijime të tjera...

Isa ILAZI



BOOM

Dr. Nora Goga,
stomatologia që solli
një dimension të ri
të mjekësisë dentare
dhe estetikës



Dr. Nora Goga, stomatologia që solli një dimension të ri të mjekësisë dentare dhe estetikës

Në një profesion që shpesh kërkon më shumë sesa aftësi teknike, Dr. Nora Goga është shembulli i një gruaje që jo vetëm ka ndjekur rrugën e babait të saj, stomatolog me 35 vjet përvojë, por ka krijuar emër të vetin, duke sjellë frymë të re në fushën e mjekësisë dentare dhe estetikës.

Klinika "Dr. Nora Goga" në Ferizaj është një prej qendrave më të besuara dhe të kërkuara në këtë fushë, duke ofruar jo vetëm shërbime stomatologjike bashkëkohore, por edhe trajtime estetike që ndikojnë drejtpërdrejt në vetëbesimin dhe mirëqenien e pacientëve. Në këtë intervistë ekskluzive, Dr. Nora ndan me ne historinë e saj, sfidat, arritjet dhe këshillat për të gjithë ata që duan të ndërtojnë karrierë në profesionet mjekësore dhe estetike...

Cila ka qenë shtytja juaj kryesore për të ndjekur rrugën e mjekësisë dentare dhe më pas të estetikës?

- Si fëmijë më pëlqente të kujdesesha për dhëmbët e të tjerëve. Ndoshta kjo dëshirë më lindi duke parë babin tim, i cili, po ashtu, është stomatolog që 35 vjet.

Teksa studioja u afrova me estetikën dentare dhe kuptova se sa e rëndësishme është për vetëbesimin e pacientit. Aty kuptova që dëshira për të ndihmuar në vetëvlerësimin e njerëzve mund të përjetohej përmes artit të buzëqeshjes.

Sa sfiduese ka qenë për ju të themeloni një klinikë tuajën dhe ta bëni një emër të besuar në këtë fushë?

- Përmes përkushtimit, punës me ndershmëri dhe vëmendjes së vazhdueshme ndaj cilësisë, klinika jonë sot është një emër që njerëzit e lidhin me profesionalizëm dhe kujdes. E këtë nuk e kam arritur vetëm, por falë babait tim që e ushtron këtë profesion një kohë të gjatë. Për mua ka qenë shumë më e lehtë të vazhdoj suksesin e tij...

A e ndjeni se si femër ka qenë më e vështirë të afirmoheni në këtë profesion dhe nëse po, si i keni tejkaluar pengesat?

- Profesionin dentar kërkon shumë energji dhe vëmendje. Si femër kam pasur paragjykimet se nuk do e kem forcën, durimin apo dedikimin e mjaftueshëm. Por, unë e ktheva këtë në motiv: me edukim, profesionalizëm dhe rezultat të

dukshëm fitova respekt. Dhjetë vjet më parë kishim pak femra modele në këtë fushë e sot jam dëshmi se e kundërta është e mundur.

Çfarë e frymëzon Norën çdo mëngjes për të qenë më e mirë si profesioniste dhe si grua?

- Çdo mëngjes më frymëzon buzëqeshja që shoh kur hap dyert e klinikës, veçanërisht të pacientëve që vijnë me shqetësime estetike.

Familja ime është drita që më mban të përqendruar.

Dua të rritem profesionalisht çdo ditë. Dhe, natyrisht, si grua, dua të jem e pranueshme dhe e dashur për bashkëshortin dhe fëmijët e mi.

Ç'këshillë do u jepni vajzave të reja që ëndërrojnë të jenë të suksesshme në profesionet mjekësore apo të estetikës?

- Puna në fushën mjekësore kërkon përkushtim të plotë, durim dhe pasion të vërtetë. Këshilla ime është të mos heqin dorë edhe kur rruga duket e gjatë apo e vështirë. Suksesi nuk vjen brenda natës, ai ndërtohet me çdo pacient që ndihmon dhe, mbi të gjitha, të kenë guxim të jenë autentike.

Si e shihni figurën e gruas sot në biznes dhe profesion, krahasuar me kohën kur filluat karrierën tuaj?

- Ka përparim të madh. Kur nisa karrierën gratë shiheshin me mëdyshje në role drejtuese apo në profesione "teknike".

Sot kemi shumë gra që udhëheqin biznese, themelojnë klinika, bëhen specialiste të kërkuara.

Por, ka ende punë për të bërë dhe jo për të provuar veten, për të ndryshuar mendësinë që roli i gruas duhet të jetë i kufizuar.

Kush ka qenë figura që u ka frymëzuar më së shumti gjatë rrugëtimit tuaj?

- Figura më e fortë për mua ka qenë babai im dhe ende vazhdon të jetë frymëzimi im. Ai më ka mësuar të mos dorëzohem dhe të kujdesem për të tjerët me përlësi.

Si arritët ta kombinoni mjekësinë dentare me fushën e estetikës dhe çfarë u motivoi për këtë zgjedhje?

- Dentistria është shumë më tepër sesa shëndet oral, është një art që formëson fytyrën dhe vetëbesimin. Estetika ka hyrë natyrshëm në punën time, sepse dëshiroja të ofroja një buzëqeshje jo vetëm të shëndetshme, por edhe të bukur. E, kur e sheh pacientin që qesh me vetëbesim pas trajtimit, është shpërblimi më i madh.

Ç'risi apo trajtime të reja keni sjellë apo synoni të sillni në klinikën tuaj?

- Kemi sjellë teknologji të avancuar për dizajnimin dixhital të buzëqeshjes, trajtime estetike minimisht invazive.

Së shpejti do të ofrojmë edhe procedura të integruara me dermatologjinë estetike për t'u ofruar pacientëve përvojë të plotë dhe të sigurt.

Cila është këshilla juaj më e rëndësishme për të gjithë ata që duan të kujdesen për shëndetin oral dhe pamjen e tyre?

- Parandalimi është çelësi. Kujdesuni çdo ditë me pastrim të rregullt, vizitë çdo 6 muaj te stomatologu dhe një mënyrë jetese të shëndetshme.

Kur kemi shëndet të plotë, atëherë mund të vazhdojmë me estetikën dhe të dukemi gjithmonë bukur.

Diç nga jeta private?

- Jeta ime jashtë klinikës është ajo që më mban të përqendruar. Më pëlqen të kaloj kohë me fëmijët, të udhëtoj.

Kam mësuar të mbaj balancën, sepse edhe Nora si nënë, si mike, si grua, ka nevojë për kohën e saj për të reflektuar dhe rimbushur energjitë.

Ishte intervistë ekskluzive. Të faleminderit!

- Faleminderit juve!

Nderim Neziri



11 vjet në luftë me vetveten!

Të ma kishin zgjedhur prindërit Malin, të dashurin, të fejuarin dhe përfundimisht burrin tim, do të hasmërohesha shumë në ta, por kur e di se unë isha ajo që isha përcaktuar për një fat të tillë, duhej me patjetër t'i përballoja të gjitha: edhe jetën, edhe mundin, edhe fyerjen, edhe ngujimin në shtëpi, edhe injorimin, madje edhe kthimin e shpinës në dhomën e gjumit...



Shkolla e mesme nuk më shkoi bash kurrqysh. Por, nuk isha njëra nga ato të shquarat për probleme e njolla të zeza. E ndjeja veten të qetë dhe, kuptohet, të lumtur që e kisha ndërgjegjen e pastër. Por, në fakultet gjërat ndryshuan. Isha e dhënë së tepërmi pas provimeve që i jepja sa mbyllë e hapë sytë.

Dhe, ç'është e vërteta, kjo më bënte të ecja balëlartë...

Shtëpia jonë ndodhej në periferi të kryeqytetit tonë, andaj edhe nuk e kishim larg qendrën. E ndjeja veten mirë, sepse nuk më pengonte askush të dilja dhe të hyja në shtëpi kur të doja.

Por, nuk e teproja...

Dhe, që nga ditët e para të fillimit të studimeve, i kisha thënë vetes që provimet t'i jepja me kohë dhe fakultetin ta kryeja brenda afatit të studimeve...

NUK PRISJA FAMILJA T'MË MARTONTE...

Por, qëllim tjetër kisha që me kohë të gjeja edhe fatin e jetës dhe të mos prisja nga familja t'më martonin, sepse kushërirat e mia ishin martuar me mesitni dhe asnjëra nuk ishte e kënaqur me jetën e tyre bashkëshortore. Dhe, meqë i dhashë me kohë provimet e qershorit, vëllezërit e mi më inkurajuan, duke më shpërblyer me një javë pushim në det, në Durrës.

E, në Durrës, derisa isha duke u larë në det me nusen e vëllait, afër nesh laheshin edhe dy të rinj, njëri prej të cilëve nuk m'i largonte sytë...

Në një moment ai gjeti rastin dhe m'u afrua afër, sa edhe ma preku dorën, duke më thënë se ishte nga Podujeva, student i Fakultetit Juridik në Prishtinë.

Dhe, që nga ajo ditë jeta ime mori kah tjetër: shumë e shumë net i kalova duke menduar pamjen e fytyrës së tij, momentin kur ma preku dorën, por edhe fjalët se do më gjej në Prishtinë, dosido...

E, kur erdhi tetori, fillimi i ligjëratave, unë isha e pranishme në sallat e mësimi fizikisht, por mendja më fluturonte gjithkrah: I mendoja dhe i bluaja në kokën time ato pak fjalë të "studentit" nga Podujeva dhe prisja çdo ditë ta hasja në korridoret e gjata të fakultetit tim...

NË TAKIMIN E PARË MË PROPOZOI FEJESË!

Në nëntor të atij viti, në hyrje të derës kryesore të fakultetit tim, u paraqit ai, djaloshi nga plazhi i

Durrësit, studenti llapjan...

Për çudi, në vend se të flisnim se si të dilnim bashkë, ai po atë ditë, teksa pinim edhe kafënë e parë bashkë në bifenë e fakultetit tim, më propozoi fejesë!

E unë në vend të përgjigjes vetëm i buzëqesha... Por, pas dimrit të gjatë, në pranverën që erdhi, u fejova me të pa u treguar në familje dhe gjatë verës planifikonim të martoheshim, ani pse dikur mendoja se pa e kryer fakultetin s'kishte as fejesë e as martesë...

U dhashë "fund" studimeve në afatin e qershorit pa dhënë, madje, asnjë provim të vetëm dhe pa i treguar kujt nga familja për "dhëndrin" e tyre të ardhshëm.

Dhe, pas një fejeje formale në familje, në shtator të atij viti edhe u bëra nuse. Madje, nuse pa pëlqimin e vëllezërve të mi, të cilit ishin kundër derisa ta kryeja fakultetin...

E, pas javëve të para si nuse filloi të errësohej bota e ëndrrave të mia, meqë burrin tim e sundonin nëna dhe motrat e tij, të cilat mua ma kishin inati, edhe pse kurrë nuk ndalesha së punuari: fshija e laja, madje edhe gatuaja...

Por, nuk mund t'i përthekeja të gjitha, sidomos kur pas tetë muajsh martesë barku im gjithnjë e më shumë fryhej...

11 VJET DUROVA...

Dhe, kur më lindi fëmija i parë, vajzë, thashë: "Tash do ndryshoj gjithçkal".

Por, shpifjet në atë shtëpi të mallkuar nuk pushonin – vetëm babanë e tij e kisha në anën time, të tjerët rrallëherë më flisnin...

Për gjendjen time në atë shtëpi nuk guxoja t'u tregoja vëllezërve.

Andaj, durova e durova rrafsh katër vjet, kur më lindi edhe vajza e dytë, duke shpresuar se dalëngadalë po lëshoja "rrënjë" në atë shtëpi...

Në anën tjetër, fati deshi dhe burri im sikur u mbush mend dhe dalëngadalë filloi të mos i dëgjojë e as respektojë urdhrat e nënës së tij, por as të motrave.

E, tek kur vajza e dytë u rritë të shkojë në shkollë, vdiq vjehrra, kurse motrat e burrit tim një nga një u martuan e zullumi prej tyre m'u hoq njëherë e përgjithmonë...

Makfretja, Podujevë

MIRË SE VINI MËRGIMTAR!

+383 49 509 090
www.cimaks.com

Hajni denoncon nënën!

Si fëmijë pata dëgjuar se një fëmijë ia kishte këputur nënës së tij gjuhën! Tregimi jepte mesazhin e qartë se një nënë e mirë e qortonte fëmijën nëse ai vidhte dhe gënjente...

RASTI I PARË

Në një portal tonin lexova se si një djalë e denonconte nënën e vet. Në fakt, dallimi mes shembullit të parë

dhe të dytë e ka një syzhe real se të dy protagonistët janë hajna. Por, nëna e rastit të parë, kur i biri vidhte, e kurajonte për vepër të mirë e në fund kur e hedhin në litar për varje, ai kërkon ta shoh nënën për herë të fundit.

Dhe, pasi ia sollën nënën, i thotë: "Nxire gjuhën se dua të ta puth si fëmija nënës!"

Dhe, pasi nëna nxori gjuhën, djali ia kafshon me dhëmbë dhe një pjesë e gjuhës së nënës mbetet në gojën e tij...

Kur e pyetën pse e bëri atë veprim, tha:

"Po të mos ishte kjo gjuhë që më kurajonte sa herë vidhja, sot nuk do e kisha kokën në litar!"

RASTI I DYTË

Rasti i dytë është edhe më trishtues, meqë djali e denoncon nënën se e kishte braktisur nga lindja dhe ai në mungesë nëne dhe edukimi ishte bërë hajn.

E, pas zbulimit nga organet e shtetit, tha se ishte fëmijë i braktisur dhe se fajtor se është dënuar është e ëma që e braktisi!

Sidoqoftë, në të dyja rastet, edukata hidhet mbi nënat që nuk i edukojnë sa duhet fëmijët...

Prandaj, jo të gjitha nënat janë edukative.

S.



Në vend se të martohemi, **ndahemi!**

Nga viti në vit, madje edhe nga muaji në muaj rritet numri i shkurorëzimeve në Kosovë. Vetëm brenda 4 muajve të fillimit të vitit 2025 mbi 500 çifte i dhanë fund martesës!

Numri i shkurorëzimeve në Kosovë ka shënuar rritje gjatë muajve të parë të vitit 2025. Vetëm në muajin prill janë regjistruar 140 raste të shkurorëzimeve, që paraqet një ngritje krahasuar me muajin mars, kur u raportuan 123 raste, apo një rritje prej 14 për qind.

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në periudhën janar-prill 2025, 528 çifte i dhanë fund martesës së tyre. Më konkretisht, në muajin janar janë regjistruar 124 raste, në shkurt 141, në mars 123 dhe në prill 140 raste të

shkurorëzimeve. Andaj, në vend se të martohemi dhe të krijojmë familje, ne, në Kosovë, ndahemi! Sikur nuk ndodh asgjë! Keq, a? Deri kur kështu?



Zoti më ndihmoftë!

Lëri aventurat, dua burrë!

Jam rritur në Suedi. Prindërit i kam nga Dukagjini. Mementalisht kam ardhur për pushim veror në Kosovë dhe do të qëndroj bajagi mirë, sepse synimi im është ta gjej një burrë që të martohem, meqë aventurave u kam mëshuar shqelm...

Jam 29 vjeçe. Jetoj në një vendbanim të vogël në periferi të Malmos. Prindërit e mi kanë punuar gjithmonë, kështu që kemi jetë të mirë. E kam kryer shkollimin e lartë dhe punoj në profesionin tim. Por, e keqja është se nuk kam qenë edhe aq e rehatshme që nga kryerja e shkollës së mesme dhe jam ngopë me aventura.

E SI TË MARTOHEM?

Në Suedi ka djem që janë të interesuar të lidhen me mua, por nuk dëshiroj të kem punë me ta, sepse ta lypin biografinë nga je, ç'ke bërë dhe kush je tash.

E kjo më bezdis.

Kam dëgjuar se në Kosovë më nuk u hyjnë këtyre punëve, por këqyrin punën dhe interesin e tyre e jo fjalët e hallkut.

Andaj, meqë jam në pushim vjetor dhe e kam kohën për martesë, jam e gatshme t'i dorëzohem personit që më ofron martesë pa kushte.

DUA BURRË ME LIDHJE FAMILJARE...

E kaluara e personit me të cilin do të lidhesha nuk më intereson. Me rëndësi është të kemi mirëkuptim dhe të di t'më trajtoj e respektoj si femër, si grua.

Po përpiqem të mos ekspozohem shumë nëpër lokale ku grumbullohen moshatarët e mi, sepse dua ta njoh një djalë a burrë nëpërmjet lidhjeve familjare, meqë vetëm në këtë mënyrë mendoj se martesë jonë do funksiononte si duhet.

Nuk jam e përkushtuar për lidhje të reja sa për t'i kaluar ditët e pushimit në Kosovë.

Qëllimi im tash është të njihem me dikë me të cilin do krijoja familje, sepse jam ngopur me aventura e dashuri.

Them edhe një herë: askënd më nuk dua ta njoh për qëllime argëtimi as në Kosovë e as në Suedi se boll qe deri më tash.

Venita



Giovanni's Beach



stourist
CAMPING



RESERVATIONS:
+382 69 336 233

mobile.apartments@gmail.com



Si ma la një njollë në shpirt profa i matematikës?

“Duhet të ushtrosh më shumë në shtëpi, në qoftë se dëshiron notë kaluese një herë, e, pastaj, edhe notë më të lartë! Pse nuk po mëson?”, ishin fjalët e profës që m’i tha gjatë vitit të katërt të shkollës së mesme...

Një çudi e pa përshkruar ndodhte me mua, pikërisht nga fillimi i të vitit të katërt të shkollës së mesme, e që edhe ishte viti i fundit, meqë në mua gjithnjë e më shumë po zgjohej një ndjenjë e pa përshkruar deri atëherë. Për absurdin më të madh, nuk mund të koncentrohesh në mësim, sepse mendtë më fluturonin gjithandej... Disi, si pakuptueshëm, po i kthehesha vetvetes, së pari, duke u shikuar më gjatë në pasqyrë, e, së dyti, duke u veshur e pispillosur më ndryshe se deri atëherë.

PËRRALLAT 1001 NET SEKS...

Në vitin e fundit të shkollës së mesme më kishin rrokur do farë ethesh të çuditshme: e ndjeja së tepërmi mungesën e një mashkulli, me të cilin do t’i përjetoja puthjet, ledhatimet dhe të shkoja me të në shtrat, që t’i përjetoja “përrallat 1001 net seks”.

Isha 18 vjeçe dhe, ç’është më e rëndësishmja, e virgjër.

Kjo edhe më pengonte, por edhe më trimëronte përpara prindërve të mi nëse kishin ndërmend t’me fejonin me zakone të kohës.

Ndonjëherë, kur më kapte sëkëlldia, kur ndodhesha brenda katër mureve krejt vetëm, merrja telefonin afër vetes dhe shtypja ndonjë numër, madje edhe të panjohur, vetëm e vetëm që të dëgjoja ndonjë zë mashkulli, sa për të thyer monotoninë që më kaplonte.

Madje, si e përdalë që isha, ndonjëherë, në telefon u bëja edhe pyetje provokuese: sa herë dëshiron të bësh seks gjatë javës, e të tjera të ngjashme. E, në realitet, unë as që kisha haber se ç’është seksi...

Kishte edhe net kur pjesën më të madhe të natës e kaloja duke imagjinuar skena erotike. Pastaj, shkoja në

banjë dhe bëja tush të vaktë, në mënyrë që ajo zjarrmi e akumuluar në trupin tim të ftohej paksa, në mënyrë që më pastaj të bëja pak gjumë, se të nesërmen më priste shkolla, mësimi...

DOJA QË PROFA T’MË OFROHEJ...

Megjithatë, ndodhi ajo që nuk do e kishte parashikuar asnjëri.

E shtrënguar të vuaja edhe unë si çdo femër tjetër e moshës sime, ishte në këtë botë një njeri, të cilit isha e gatshme t’i dorëzohesha dhe ta lejoja me gjithë dëshirë të më “rrëzonte”. Ç’është e vërteta, profa i matematikës nisi t’me pëlqej, ani pse detyrat e algjebres nuk i kuptoja fare...

Një ditë, profa, derisa na i kontrollonte detyrat e shtëpisë, u ndal pak më gjatë pranë bankës sime, duke u munduar t’i sqaronte paksa më gjatë detyrat e algjebres.

Por, unë nuk e kisha mendjen aty...

E ndjeja frymëmarrjen e tij afër gojës sime.

Të nesërmen e takova në korridor të shkollës dhe më tha se në fund të mësimit kishte për të biseduar me mua... Dhe, kur erdhi koha të bisedonim, më tha: “Duhet të ushtrosh më shumë në shtëpi, në qoftë se dëshiron notë kaluese një herë e, pastaj, edhe notë më të lartë. Pse nuk po mëson?”.

Nuk kisha përgjigje. Nuk kisha guxim t’i thosha se unë e doja. Nuk kisha guxim t’ia hapja zemrën, sepse frikësohesha se do më qortonte, do më largonte nga vetja.

Dhe, ç’ndodhi pastaj?

Erdhi edhe fundi i vitit shkollor. Në matematikë më dha notën 3. E kreu shkollën e mesme, por kurrë ndjenja për profën tim të matematikës nuk m’u shua...

Ermira, Prizren



Revolucion në
DOBËSIM
Worldwide franchise



E themeluar në vitin 2011 nga Shkenda Dubova, me një qendër fillestare në Prishtinë.
Rrugëtimi ynë nisi në një kohë kur aparaturat nuk njiheshin në vendin tonë.
Qendra jonë solli një inovacion për tregun Kosovar dhe jo vetëm.
Kjo na bëri të ndihmojmë shumë njerëz duke përmbushur ëndrrat e tyre.



MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail.com



Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depressive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail.com

Nuk po mund të mbetëm shtatzënë!

Jam një grua, 38-vjeçare, jetoj në Shqipëri. Jam martuar pak me vonesë, por nuk po mund të mbetëm shtatzënë. Kohëve të fundit jam edhe nervoze shumë dhe po më pengon gjithçka. A do të kem fëmijë?

“Mbrëmja”

Përgjigje:

Stresi krijon frikë dhe ti ke edhe nervozë. Pra, edhe frikë e edhe nervozë. E, këto të dyja pengojnë mundësinë e shtatzënisë. Nuk është që nuk ka mundësi të mbetesh shtatzënë edhe duke qenë nervoze, por kjo mund të jetë arsye pse po dështon të krijosh shtatzëni.

Nëse analizat spermografike pasqyrojnë gjendje të mirë të ti dhe të burrit, atëherë ka mundësi që ekziston një arsye subjektive që është pengesë e vogël për shtatzëni, e ajo që duhet të bësh ti është ta lirosësh kokën nga nervoza dhe stresi dhe ta racionalizosh sjelljen konform nevojave.

A është mëkat të festohen ditëlindjet?

Jam 67-vjeçare. Përcjell rregullisht rubrikën tënde. Dua

të di: A është mëkat të festohet ditëlindja, sepse kam dëgjuar se nuk duhet festuar ditëlindjen?

Të lutem, një sqarim...

“Gjyshja nga Rahoveci”

Përgjigje:

Nuk kam lexuar askund se është e ndaluar të festosh ditëlindjen...

Festimi i ditëlindjes është normale të kremtohet me një festim të mundësive familjare.

Te ne fliten shumë gjëra dhe detaje që dikush i thotë me bindjet e veta laike dhe tema, pastaj, bëhet si diçka “kuranore”.

Për shembull, prindërit dhe të dashurit tanë familjarë që kanë vdekur dhe pushojnë në ahiret, kanë nevojë të kujtohen nga të gjallët, duke ditur në shumë breza se cila familje rrjedh prej cilës dhe kush çka e ka dikë tjetër.

Por, njerëzit tanë nuk kanë orientime afatgjata sa u përket njohjes së gjenit të trashëgimisë. Nëse dikush shkon te varret për dua, lutje, shumica absolute mund t'i bëjnë ato deri te babagjyshi e jo më larg. Në adetet tjera ceremoniale të popujve të emancipuar, kjo njohje mund të shkojë deri

në pesë breza, sepse ata kanë ruajtur elementin e identitetit në varreza...

Jam e brengosur për djalin tim

Jam një nënë e brengosur për fatin e djalit tim. Ai e ka kryer fakultetin, por ende nuk ka gjetur punë. Ka konkurruar në disa vende pune, por nuk është pranuar dhe për këtë arsye nuk do martesë.

Megjithatë, shpesh më shkon mendja se ka magji që nuk po martohet...

“E brengosura nga Prishtina”

Përgjigje:

Martesa është obligim për çdo njeri të cilësdo gjini. Djali ka rezonuar me vend se pa u punësuar nuk do martesë, sepse dihet ana sociologjike në martesë, meqë kur bëhen fëmija edhe i kërkojnë gjërat e kohës, pa të cilat më nuk mendohet rritja e fëmijës.

Andaj, djali, me siguri, llogaritet në këto gjëra...

Por, pa marrë parasysh a vlen kjo a jo, ai një ditë duhet ta gjej fatin e vet.

Sot pak djem në Kosovë nuk e kanë të kryer fakultetin, bile edhe masterin, por edhe po të punësohen nuk kanë kushedi farë rroge sa ta mbajnë familjen me pagën mujore.

Unë nuk shoh se ka magji djali juaj, por shoh te ai një vizion normal jetësor, duke mos dashur martesë pa pasur parane e vet.

Ma morën pronën të mëdhenjtë!

Përsëritet zonjë, jam nënë, 61-vjeçare. Kam punuar në

arsim shumë vjet. Pasluftë kemi blerë një pronë, të cilën pas do vjetësh na e morën padrejtësisht, duke u sistemuar në tokat katastrale që u shpallën pronë industriale.

Kemi reaguat dhe jemi në kërkim të drejtësisë...

A do të na rikthehet prona që e kemi blerë?

“Pa shifër”

Përgjigje:

Shpesh ndodh të mos jetë e mjaftueshme vetëm të blini diçka, por duhet të kishit llogarit, para së gjithash, nga vjen prona, a ka dokumentacion valid e të tjera...

Nastradinin e kishte pyetur një gjyqtar:

“A do i marrësh 100 lira apo drejtësinë?”

Nastradini përgjigjet:

“Lirat do i merrja”.

“Pra, po e humbë drejtësinë, a?”

ia ktheu gjyqtari.

Nastradini i tha:

“Secili merr atë që i mungon!”

Kur do më vjen fati?

Përsëritje magjistare, jam vajzë, 40-vjeçare, nuk kam qenë e fejuar asnjëherë.

Thjesht, më është shtyrë fati dhe kështu kam dalë disi nga “loja”...

A do të kam fat dhe kur do e gjej?

“Rufa”

Përgjigje:

Sipas shikimit tim, do martohesh sivjet, pak para Vitit të Ri. Do arrish ta bashkosh fatin me një person që ka fëmijë, por nuk ka grua.

Pse vajza ka rënë në mësim?

Jam një nënë, i kam tre fëmijë. Vajza e madhe tani i mbushë 15 vjet.

Ka qenë më e mira në shkollë në mësim, por ka rënë shumë nga kualiteti mësimor. Po ankohen edhe arsimtarët, duke më pyetur se çka ka ndodhur me të... Të lutem, çka ka ndodhur me të dhe a do t'i rikthehet mësimi?

“Për vajzën 15 vjeçe”

Përgjigje:

Vajza juaj ka kaluar në një fazë më të rritur, e cila i ka sjellë edhe ndryshime hormonale, që është një proces normal për moshën e saj dhe që shfaqet nga moshë 12 apo 13 vjeç.

Nuk është për brengosje ky proces, sepse është punë e zhvillimit të saj, e që tregon se ajo është në rregull sa i përket anës fizike. Ka mundësi me iu rikthye mësimi përsëri, sepse intelekt i saj e ka potencialin për rezultate domethënëse.

Ç’po ndodh me familjen time?

E nderuara magjistare, kam shumë besim në ju, andaj edhe kërkoj ndihmën tuaj...

Familja jonë çdo ditë e më shumë po shkatërrohet.

Burri është i sëmurë, e barërat nuk i ndihmojnë fare.

Djali zgjohet natën jerm dhe po të mos e hetoj del nga shtëpia...

Ju lutem, më tregoni, çka po ndodh me ne?

“E mërzitura”

Përgjigje:

Nëse barërat nuk i ndihmojnë burrit tënd, është shenjë e avan-

PËR LEXUESIT E DIASPORËS

Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: “Kosovarja”, fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

cimit të stresit.

Dhe, kur stresi merr fuqinë, zor është ta ndalin barërat.

Për shembull, te rastet e presionit të lartë të gjakut, kur kemi të bëjmë me tension stresor, shumë më vështirë normalizohet tensioni sesa kur ai është nga ushqimi...

Në rastin tjetër, mosndikimi i barërave ka mundësi të jetë i lidhur me terapi të gabuar.

Ndërsa, djali që zgjohet jerm, nuk është për brengosje, sepse ai është një proces në kuadër të normalitetit njerëzor e nuk shkaktohet prej ndonjë faktori jonormal.

A do të takohemi përsëri?

Jam një vajzë 31-vjeçare. Vitin e kaluar, gjatë verës, jam takuar me një person në Shëngjin dhe kemi ndenjur dhjetë ditë bashkë.

Ai më është lajmëruar vetëm një herë pasi ka shkuar në Perëndim.

A do të takohemi edhe sivjet ashtu qysh e kemi lënë takimin vitin e kaluar?

“Pritja”

Përgjigje:

Do të takoheni përsëri, por ai është i martuar. Është, së paku, 15 vjet më i vjetër se ti.

Do të takoheni në fund të gushtit, por përsëri do të metësh me gishta n’gojë...



DENTFIX
ORDINANCA STOMATOLOGJIKE



Prof. Asoc. Dr FEHIM HALITI



Part of DENTFIX GROUP



@dentfix ks

+383 44 22 55 34

www.dentfix-ks.com

Ahmet Krasniqi Str. No 137,
Pristina, Kosovo



CARE & HAIR FIX
ESTHETICS & HAIR TRANSPLANT CLINIC

